



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian

Mitrovicë, 25 Tetor 2024

**FTESË PUBLIKE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-VE PËR VITIN 2024
NË FUSHËN E TURIZMIT DHE MJEDISIT.**

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian duke u bazuar në RREGULLOREN MF - NR – 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE ¹i fton organizatat e regjistruara si **OJQ** (sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare t në Republikën e Kosovës), e me bazë në Mitrovicë, programi i të cilave është i fokusuar në përkrahje të projekteve me qasje inovative në trajtim të tematikave të Turizmit dhe Mjedisit në Mitrovicë me theks të veçantë në zhvillimin e atraksioneve turistike dhe hapësirave të gjelbra, që të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet-idetë me karakter:

- Profesional, të cilat me kualitetin e tyre formal dhe përmbajtjesor i respektojnë standardet evropiane;
- Stimulues, të cilat kanë për qëllim evidentimin e ideve të veçanta kreative në fushën e turizmit dhe mjedisit;
- Tradicional, përmes të cilave do të promovohen vlerat autentike turistike;
- Inovativ, të cilat me formën, përmbajtjen, frymën dhe mënyrën e realizimit të tyre paraqesin risi për fushën e turizmit dhe mjedisit;

2. OJQ-të, në përputhje me këtë ftesë publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për projekte me qasje inovative në trajtim të tematikave të Turizmit dhe Mjedisit në Mitrovicë me theks të veçantë në zhvillimin e atraksioneve turistike dhe hapësirave të gjelbra .

3. Vlera totale e planifikuar e ftesës është **45,000.00 Euro**.

- Shuma minimale e mbështetjes financiare për OJQ-të që mund të alokohet për çdo projekt është **4,000.00 Euro**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **15,000.00 Euro**.

4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 15.11. 2024.

5. Kriteret administrative për OJQ-të:

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret administrative të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
- të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
- të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete; dhe
- të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Vërtetimin që OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK).
- Veprimtarin e organizatës ta ushtrojnë në qytetin përkatës të thirjes.
- Të mos ketë pranuar mjete financiare brenda vitit 2024 nga Komunë e Mitrovicës së Jugut.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

6. Kriteret përmbajtësore të vlerësimit:

Me rastin e vlerësimit të projekt-propozimeve, Komisioni do të vlerësojë me sa vijon:

- a posedon OJQ-ja, kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit /programit (a kanë aftësitë e duhura dhe aftësitë për zbatimin e projektit, si dhe njohuri në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë ftesë)

- a posedojnë kapacitete të menaxhimit të mjaftueshme OJQ-ja (duke përfshirë personelin, pajisjet për të udhëhequr me projektin)?
- a është i përcaktuar ekipi i projektit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit?
- sa relevant është projekt-propozimi për qëllimet dhe fushat të ftesës publike (a ndërlidhet projekti me aktivitetet e parapara me politikat e fushës, të cilat i mbulon ftesa publike)?
- a janë objektivat e projektit/programit të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?
- a janë aktivitetet e projektit / programit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme?
- a janë kostot e projektit/programit reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?
- a janë kostot e projektit në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projektit/programit?

OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti (1) projekt në kuadër të kësaj ftese publike. Periudha e zbatimit të projektit është më së largu 6 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e promovimit dhe zhvillimit të turizmit dhe mjedisit. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës (menaxheri) në OJQ nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ, ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në web-faqen e Komunës së Mitrovicës: <https://kk.rks-gov.net/mitrovice>

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Mitrovicës

Kati i parë, zyra pritëse

Rruga “Bedri Gjinaj”, 40,000 Mitrovicë

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të ftesës është i detajuar në Udhëzimet për aplikuesit.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë ftesë publike, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: **bedri.murati@rks-gov.net**

Dokumentet që duhet të plotësohen janë të bashkangjitura (të shkarkohen dhe të plotësohen):

[F9-Formulari-i-Aplikacionit-per-projekt](#)

[F10-Formulari-i-propozim-buxhetit-per-OJQ](#)

[F11 Forma e deklarates per financimin e dyfishte](#)

[F12 Formular i deklarates se partneritetit](#)

[F13 Forma e deklarates se projekteve te financuara](#)

[F14.-Deklarate-mbi-aktivitetet-e-pershkruara-per-kontraktoret](#)

[Formulari 15 per vleresimin e aplikacioneve](#)

[Formulari 21 Vleresimi administrativ](#)